



Universität
Zürich UZH

HAP-PAS-HAPI

GUR-GUR, BËHET MUR, MUR-MUR BËHET KALAJA.

Psychologisches Institut

Psychopathologie und Klinische Intervention

Binzmühlestrasse 14/17

CH-8050 Zürich

Udhëheqësja e projektit:

PD Dr. Eva Heim

Koordinatorë e projektit:

Mag. phil. Mirëlinda Shala

Kërkohen pjesëmarrës për studim shkencor

Hap-pas-Hapi është një program për të ndihmuar njerëzit të përballen më mirë me mërzë dhe stres.

Ky program i ofrohet popullatës shqiptare, e cila jeton në Zvicër dhe Gjermani, nga Universiteti i Cyrihut, Zvicër në bashkëpunim me Freie Universität Berlin, Gjermani.

Ne kemi nevojë për shumë njerëz për ta provuar programin. Ju lutemi bashkohuni për të mbështetur studimin tonë!

Nëse jeni mbi 18 vjeç, flisni gjuhën shqipe, dhe jeni duke përjetuar emocione të vështira, stres ose gjendje të mërzisë, atëherë ju ftojme të merrni pjesë në këtë studim.

Synimi i studimit

Hap-pas-Hapi është një program mbështetjeje i bazuar në prova shkencore, i siguar përmes një aplikacioni smartphone ose një faqe në internet, dhe ne po e vlerësojmë atë në një projekt kërkimor. Qëllimi i studimit tonë është të krahasojmë dy versione të programit për të zbuluar se cili version përdoret më shumë dhe funksionon më mirë.

Procedura dhe kohëzgjatja e studimit

Pas regjistrimit, do t'ju bëhen pyetje në lidhje me situatën tuaj aktuale emocionale. Nëse i plotësoni të gjitha kriteret, do t'ju kërkohet të plotësoni një seri pyetësorësh. Pas kësaj, ju do të merrni rastësisht një nga dy versionet e Hap-pas-Hapi. Pastaj mund ta përdorni programin për një periudhë prej gjashtë javësh. Pas përfundimit të programit dhe tre muaj më vonë, do t'ju kërkohet të plotësoni përsëri pyetësorët.

Kompensimi: Nëse e përfundoni studimin plotësisht, do të merrni një kupon me vlerë **30 Euro**.

Ju merrni pjesë **vullnetarisht**. Nëse dëshironi të tërhiqeni nga pjesëmarrja juaj më vonë, ju mund të tërhiqeni pa dhënë arsye.

Të gjitha të dhënat do të trajtohen në mënyrë **konfidenciale**.

Nëse ne kemi ngjallur interesin tuaj për të marrë pjesë në studim dhe ju i përmbushni kriteret e mësipërme, atëherë vizitoni faqen tonë të internetit ose na dërgoni një e-mail.

Ju mirëpresim!

Webfaqe: happashapi.org

E-Mail: happashapi@psychologie.uzh.ch

